

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE**

**PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT**

**LËNDA: Gjuha italiane**

**(klasa e tetë)**

**Tiranë, 2005**

## **PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

- I. TË PËRGJITHSHME
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE
- III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
- IV. AKTET, FUNKSIONET KOMUNIKUESE
- V. SFERA TEMATIKE DHE LEKSIKU
- VI. ELEMENTE DHE STRUKTURA GRAMATIKORE
- VII. SHPËRNDARJA E ORËVE
- VIII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- IX. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI

### **I. TË PËRGJITHSHME**

#### **I.1. HYRJE**

Integrimi i vendit tonë në gjirin e familjes evropiane kërkon njohje dhe zotërim të efektshëm të gjuhës së huaj, që t'u lejojë nxënësve të arrijnë shpejt një autonomi të përdorimit të saj nëpërmjet mjeteve të përshtatshme për një komunikim imediat.

Ky program nënkupton drejtimin, mbështetjen dhe nxitjen e nxënësit me nevojën për t'u përshtatur, për t'u shprehur, për të komunikuar në mjedise shkollore dhe jashtëshkollore në gjuhën italiane.

Në kuadrin e ndryshimeve të sistemit shkollor (shtrirja e arsimit të detyruar 9-vjeçar), plani mësimor i gjuhës italiane në klasën VIII, përmban 3 orë javore.

Duke pasur parasysh moshën e nxënësit, në program është bërë përshtatja e kësaj grup-moshe me tematikën, objektivat, aktet dhe funksionet komunikuese.

Programi i klasës së tetë mbështetet në njohuritë dhe aftësitë e përfituara nga nxënësit në klasat paraardhëse, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato. Synimet dhe objektivat didaktikë, të paraqitura në këtë program, janë mbështetur dhe ngrihen mbi nivelin e njohurive të programeve të klasave III – VII, duke i riparë dhe ridimensionuar ato.

Në përgatitjen e këtij programi, autorët u janë referuar dhe i janë përmbajtur strukturës, niveleve dhe përcaktimeve të vizionit kurrikular e të kurrikulës kombëtare të gjuhëve moderne (MASH, 1999), si dhe kuadrin të përbashkët të referencave të Këshillit të Evropës (Strasburg, 1998).

## I.2.PARIME

Ashtu siç është paraparë edhe në kuadrin e përgjithshëm të kurrikulës, mësimdhënia / mësimnxënia e gjuhës së huaj, pra edhe e gjuhës italiane bazohet dhe mban parasysh parimet, synimet dhe objektivat që ka përcaktuar shkolla jonë. Ato u përgjigjen:

- zhvillimit të një kulture demokratike,
- nevojave dhe interesave individuale të nxënësve,
- bartin gjerësisht përvojën bashkëkohore arsimore në botë.

Me synimin për të përmirësuar në vazhdimësi procesin mësimor në këtë hallkë të sistemit shkollor, janë mbajtur parasysh:

- ruajtja e atyre pjesëve të përshtatshme të kurrikulës ekzistuese dhe integrimi i tyre me elemente të reja ku të jetë e nevojshme;
- liria dhe pavarësia e mësuesit,
- nxitja dhe përdorimi i metodave e materialeve mësimore që mbështetin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore të nxënësit,
- forcimi i pozitës që nxënësi ka si qendër e procesit mësimor,
- nxitja e përdorimit dhe e studimit të materialeve autentike, me burim nga masmedia e shkruar dhe e folur,
- ndërgjegjësimi i nxënësit për identitetin e vet kulturor, nxitja dhe motivimi i tij për ta krahasuar atë me kulturën e vendit fqinj.

## II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE

### 2.1. Synime

Në kuadrin e synimeve të arsimit të detyrueshëm , përmes mësimit të gjuhës së huaj, konkretisht të gjuhës italiane, synohet:

-nxitja e zhvillimit konjitiv të nxënësit përmes një mjeti të ri organizimi e transmetimi njohurish (zhvillimi i individualitetit të nxënësit; zhvillimi i të nxënët të pavarur, zhvillimi i mendimit kritik etj.);

-krijimi i mundësive, përmes kodit gjuhësor, që nxënësi të njohë e të kuptojë kulturën e vendit tjetër (zhvillimi i ndërjegjësimit për identitetin kulturor; zhvillimi i tolerancës dhe i respektit për diversitetin mes njerëzve e kulturave etj.).

## **2.2. Objektiva të përgjithshëm**

Synohet një zhvillim, deri diku i baraspeshuar, i të katra aftësive bazë (të kuptuarit dhe të shprehurit me gojë, të kuptuarit e të shprehurit me shkrim), duke i dhënë përparësi zhvillimit të aftësisë gjuhësore e komunikuese të nxënësit.

**2.2.1. Aftësi gjuhësore** nënkupton njohjen pasive dhe aktive (të kuptuarit dhe të shprehurit) të strukturave gjuhësore bazë, në aspektin e tyre:

- fonetik,
- morfologjik,
- sintaksor,
- leksikor,
- funksional.

Përmes njohjes së strukturës, të leksikut dhe funksioneve, nxënësi, gjatë studimit të gjuhës italiane do të njohë edhe kulturën dhe qytetërimin që ajo gjuhë bart. Kjo do të bëjë të mundur edhe ballafaqimin me kulturën dhe qytetërimin e vet kombëtar.

Vëmendja e përqendruar për gjuhën e folur kërkon veprimtari të përqendruara mbi përdorimin praktik të strukturave dhe elementeve komunikuese. Vërejtjet gramatikore do të duhet të bëhen vetëm në vijim të këtij procesi dhe për të forcuar nxënien e strukturave në fjalë. Gramatika të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive që të nxitet nxënësi drejt një procesi analitik dhe mendimi kritik. Vetëm përmes tekstesh leximi, kryesisht autentike, të bëhet paraqitja dhe futja e strukturave dhe/ose e rregullave gramatikore dhe jo si një proces shpjegimi statik tabelash apo rregullash.

**2.2.2. Aftësi komunikuese** nënkupton të përdorurit në mënyrë të pavarur kodin gjuhësor, në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme me situatat komunikuese të dhëna, situata që lidhen me kontekstin e përgjithshëm e të përditshëm të jetës së nxënësit. Në këtë kuadër trajtohen edhe elemente të natyrës jashtëgjuhësore (gjestet, mimika, prosemika etj.), të cilat mësuesi, në varësi të rrethanave konkrete në procesin mësimor, i përdor dhe ua shpjegon edhe nxënësve kuptimin dhe përdorimin.

## **2.3. Objektiva specifike**

### **2.3.1. Aftësitë**

Aftësia komunikuese do të zhvillohet përmes ushtrimit të katër aftësive gjuhësore bazë, të cilat integrohen njëra me tjetrën në masë të baraspeshuar atje ku është e mundshme dhe e përshtatshme. Aftësitë gjuhësore janë:

- (a) të kuptuarit me gojë (dëgjimi dhe reagimi),
- (b) të kuptuarit me shkrim (leximi),
- (c) të shprehurit me gojë (të folurit),
- (d) të shprehurit me shkrim (të shkruarit).

### **2.3.2. Objektivi socialkulturor**

Strukturat gramatikore e leksikore përvetësohen më mirë të vendosura në kontekst përdorimi më të gjerë. Integrimi i elementeve të qytetërimit në mësimin e

gjuhës së huaj shton motivimin e nxënësve, duke i çuar ata në një realitet tjetër të ndryshëm nga ai ku jeton. Ai ngjall interesim, kërkuesi për vendin gjuhën e të cilit është duke mësuar, për zakone, rite, norma të ndryshme nga të tjerët. Ai zgjeron njohuritë dhe kulturën e tij të përgjithshme.

### **III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE**

#### **3.1. Të dëgjuarit**

Nxënësi në përfundim të klasës së tetë:

- tregon se kupton tekste të gjuhës së folur lidhur me tema të njohura për të, me tema të gjuhës familjare dhe jofamiljare e që kanë të bëjnë me ngjarje të shkuara, të tashme e të ardhme;
- është në gjendje të kuptojë gjuhën e folur me shpejtësi mesatare në çdo rrethanë;
- tregon se kupton një material me përmbajtje të thjeshtë dhe me fjali komplekse dhe shprehje me gjuhë jofamiljare;
- diskuton për tekste paksa të vështira dhe tema të panjohura për të vendosur lidhje me të tjerët për të shprehur ndjenja, dëshira, për të kërkuar dhe për të dhënë informacion;
- dallon dhe përcakton thelbin në ndonjë lajm për ndodhi të ndryshme në njoftimet televizive kur shoqërohen me figurë dhe komente të shkruara.

Arritja e aftësisë në dëgjim do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë:

- *Dialogjesh* që lidhen me:
  - situata në familje, në mjedisin shkollor, në mjedise publike (dyqan, bar etj.), kremtime, hartime ftesash;
  - situata me lojërat dhe kohën e lirë;
  - informacione për shkollën, familjen, argëtimin etj.
- *Monologjesh* që lidhen me:
  - lajmërimi shkollor, njoftime të shkurtëra radiotelevizive,
  - përsëritje me mysafirët, biseda me ta.

#### **3.2. Të folurit**

Nxënësi në përfundim të klasës së tetë:

- merr pjesë në bashkëbisedime, duke kërkuar e vjelë informacion dhe mendime, duke përdorur terma që kanë të bëjnë me përvoja të shkuara, të tashme apo dhe me projekte të së ardhmes, me veprimtari dhe me interesa që i përkasin jetës së përditshme;
- është i kuptueshëm për të tjerët në ato që thotë, edhe pse mund të bëjë disa gabime;
- diskuton me dikë për çka do të bëjë dhe ku do të shkojë; lë orën dhe vendin e takimit;
- përballon disa situata në të cilat ndodhet gjatë një udhëtimi në vendin ku flitet gjuha që mësohet, për të plotësuar nevojat e veta;
- di të bëjë një përshkrim të njerëzve, të rrethanave jetësore, të veprimtarisë së përditshme, të asaj që i pëlqen apo jo;
- ndërvepron në mënyrë të thjeshtë në komunikime të përditshme nëse frazat shqiptohen me një ritëm gati normal;

- diskuton rreth temave të përditshme dhe problemeve personale me shqiptimin dhe intonacionin mjaft të saktë;
- shpreh kuptimin e gjerë të pasazheve më të gjata, plot fjalë të panjohura të përcjella me shpejtësi normale;
- dallon qëndrimet kryesore të shprehura në diskutim ose pjesë më të gjata;
- bën pyetje të thjeshta dhe përgjigjet, merr nisativën në të folur dhe reagon ndaj pohimesh të thjeshta që lidhen me nevoja imediate apo me çështje të njohura për të;
- komunikon në veprimtari, në të cilat kërkohet një shkëmbim informacioni rreth çështjesh të njohura që lidhen me familjen, shkollën, lojën dhe kohën e lirë;
- hyn dhe merr pjesë në biseda ku kërkon informacion dhe bën veprime në mjedise të njohura (dyqan, shkollë, postë, bibliotekë etj.);
- zotëron një fjalor të mjaftueshëm për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm.

Arritja e aftësisë së të folurit do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë:

- *Monologjesh* në të cilat:
  - di të flasë për veten, familjen, miqtë, vende, persona, botën e imagjinatës dhe të krijimtarisë etj.;
  - flet për mësimet, për kohën e lirë, pasionet, zakonet vetjake, kulturën popullore, përshkruan një përvojë të caktuar;
  - bashkëveprimi* me mësuesin/nxënësit për tema të njohura;
  - role-play* të thjeshta, në të cilët riprodhohen situata të njohura.

### **3.3. Të lexuarit**

Nxënësi në përfundim të klasës së tetë:

- identifikon dhe vëren pikat kryesore, si dhe detajet specifike në tekste për tema të njohura;
- kupton mesazhe mesatare të shkruara në kartolina, letra korrespondence apo në postë elektronike;
- gjen informacion në materiale me përdorim të përditshëm shkollor;
- kupton e ndjek udhëzime të shkruara për detyra, ushtrime apo lojëra;
- kupton tregime të shkruara me tema të jetës së përditshme;
- kupton tekstin me përmbajtjen nga një temë familjare dhe përgjigjet me fjali komplekse dhe gjuhë jofamiljare; seleksionon materiale familjare për aftësitë e leximit individual;
- përzgjedh materiale që i përshtaten aftësive të tij individuale për të lexuar dhe tregon se i kupton mirë shkrimet për shoqërinë në vendin e gjuhës që mësohet.
- kupton dhe reagon për shkrime me përmbajtje disi të panjohur, gjen dhe kupton informacion apo faktet e kërkuara, p.sh., kush e kryen, ku dhe kur është kryer diçka;
- kupton tekste të shprehura me gjuhën e përdorimit të përditshëm.

Arritja e aftësisë në të lexuar do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste, si:

- kartolina, letra,
- fletëpalosje, tabela apo reklama, gazeta e revista,

-lajmërimë, udhëzime të thjeshta (rregulla ushtrimi, loje etj.), paralajmërimë rreziku etj.

### **3.4. Të shkruarit**

Nxënësi në përfundim të klasës së tetë:

- shkruan pasazhe rreth temave të njohura me stile të përshtatshme për kontekste të reja të veçanta;
- kërkon dhe jep informacion për gjuhën me interes të veçantë;
- shkruan struktura të thjeshta duke gabuar herë pas here, si, p.sh., në përdorimin e kohëve, por jep zakonisht qartë atë ç'ka përpiqet të shprehë;
- shkruan hartime duke përdorur fjalorin për tema të njohura;
- krijon mikrodialogje;
- shkruan tekste të shkurtëra, duke u bazuar në interesa dhe burimet e tyre;
- përdor gjuhë formale dhe joformale me nivel të thjeshtë;
- shfaq përdorimin në fazë fillestare të elementeve gramatikore në kontekste të reja, edhe pse me disa gabime;
- përdor fjalorin për gjetjen dhe ruajtjen në kujtesë të termave që nuk njih;
- kërkon dhe jep informacione me shkrim, në kartolina e letra;
- përshkruan njerëz, vende, veprimtari të përditshme, atë që i pëlqen apo jo, përmes frazash paksa të vështira.

Arritja e aftësisë në të shkruar do të realizohet nëpërmjet materialesh të shkruara, si:

- module apo formularë (shkolle, biblioteke etj.),
- kartolina, letra,
- lajmërimë në një kënd të posaçëm apo në gazeta për fëmijë, receta kuzhine, përgatitje posterash, përdorim materialesh burimeve etj.

#### **IV. AKTET, FUNKSIONET KOMUNIKUESE**

Nxënësit duhet të ushtrojnë e të përvetësojnë një sërë funksionesh apo aktesh komunikuese që, duke patur parasysh grup-moshën, nevojat dhe interesat e tyre, si edhe objektivat edukativo-mësimorë të ciklit të mesëm të ulët (klasat VI-IX), do të arrijnë përgjithësisht:

- të ndjekin udhëzime;
- të pyesin, të përgjigjen dhe të japin shpjegime;
- të nisin dhe të zhvillojnë një bashkëbisedim, një bisedë telefonike;
- të shprehin miratim, refuzim, ndjesi dhe opinione vetjake;
- të kërkojnë dhe të japin informacion;
- të shprehin pëlqime dhe reagime;
- të paraqiten e të paraqisin të tjerët;
- të pyesin e të përgjigjen për gjeneralitetet (emër, mbiemër, kombësi, shtetësi, moshë, vendbanim, adresë, numër telefoni etj.);
- të pyesin e të përgjigjen për profesionin e të afërmeve;
- të përshëndetin e t'u përgjigjen përshëndetjeve;
- të pyesin e të japin mendim për persona, objekte, sende dhe vende;
- të bëjnë ftesa, propozime, t'i pranojnë apo t'i refuzojnë ato;
- të pyesin e të përgjigjen për çka dinë të bëjnë (gjuhët, sportet, hobet etj.);
- të shprehin kënaqësi apo moskënaqësi, qëllime apo synime;
- të tregojnë fakte në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen;
- të bëjnë krahasime;
- të shprehin pëlqim apo mospëlqim, nevoja apo dëshira;
- të kërkojnë e të thonë vendndodhjen e objekteve të ndryshme;
- të kërkojnë e të porositin diçka në dyqan, në supermarket, në zyrat publike;
- të pyesin për çmimin dhe vlerën;
- të hapin, të vazhdojnë e të mbyllin një bisedë telefonike;
- të shkruajnë mesazhe personale, si edhe letra me karakter informal dhe formal.

#### **V. SFERAT TEMATIKE DHE LEKSIKU**

Përmbajtja tematike e programit të klasës VIII është rimarrje e asaj që është trajtuar në ciklin e mëparshëm (klasat III-VII), por në formë më të pasuruar e më të thelluar në planin leksikor, gramatikor, komunikues.

Në tërësi, mbeten të njëjta sferat tematike, ashtu si në nivelin parardhës. Sipas parimit spiral (rimarrja në mënyrë më të zgjeruar), ritrajtohen në një nivel më të lartë e më të gjerë temat e mëposhtme të grupuara në 7 fusha apo sfera, sipas konceptimit të kurrikulës kombëtare, vizionit kurrikular dhe kuadrit të referencave të Këshillit të Evropës:

##### **5.1. Tematika**

Rimerren pjesa më e madhe e temave dhe çështjeve të trajtuara në pesë nivelet pararendëse (klasa III-VII) që lidhen me interesat dhe nevojat e kësaj moshe, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e përmbajtjes, por në formë më të zgjeruar.

*a. Veprimtaria e përditshme:*

Tregu, shpenzimet në treg, rrugë a në supermarketë;

Familja, të afërmit, marrëdhëniet familjare, ndarja e detyrave në familje;



Kafshët shtëpiake; llojet e tyre;  
Festat familjare; organizimi i festës, tavolina, dhurata, ëmbëlsira; veshja sipas stinës e dhe rasteve speciale, tregjet;  
Shokët dhe shoqet e lagjes; marrëdhënia me to;  
Koha e lirë dhe hobet; lojërat, pasionet, librat etj.;  
Ditët, muajt, datat, orët;  
Shtëpia, mjediset e brendshme, objektet apo sendet në të, llojet e banesave; efektet e teknologjisë në rutinën e një shtëpie;  
Guzhina, ushqime dhe pije (ndonjë veçori e kuzhinës shqiptare dhe italiane).

*b. Jeta personale dhe shoqërore:*

Shëndeti, sëmundjet, tipat e sëmundjeve të përgjithshme, trupi, higjiena; njohja me rregullat e higjienës;

Mënyra e të veshurit, prirjet; moda;

Karakteristika të shokëve dhe të popullit italian;

Popujt dhe pamja e tyre e jashtme (momente ndërkulturore); miqësi të reja; në plazh; në chat, me e-mail etj.

*c. Bota rreth nesh, mjedisi fizik në vend dhe në botë:*

Qyteti, shtetet, kontinentet;

Koha, moti, stinët, klima;

Adresa, mjetet e transportit e të telekomunikacionit; TV, radio, SMS, cel., e-mail;

Udhëtimet e bëra apo që dëshirohet të bëhen; trafiku;

Vende takimi dhe argëtimi, monumente arti e historike;

Monedhat, dyqanet, tregu; mjedisi, natyra e vendit, industria, bujqësia;

Zyrat publike; bashkia (komuna) dhe personeli, gjendja civile.

*ç. Bota e arsimit, trajnimit dhe punës:*

Shkolla, klasa, objektet përreth, orari; mësuesit, drejtuesit, marrëdhëniet me ta, përshkrimi i personalitetit;

Shokët dhe shoqet e grupit, marrëdhëniet me ta;

Personeli i shkollës; marrëdhëniet me ta;

Një ditë në shkollë;

Lënda mësimore dhe preferencat lëndore; lënda e re dhe mendime për lëndën;

Përcaktimi i veprimtarive (lexim, shkrim);

Librat dhe biblioteka, llojet e gjinive: aventuresk, shkencor; numrat dhe veprimet aritmetike; formimi i klubeve, grupeve etj.;

*d. Bota e komunikimit dhe teknologjisë, komunikimi në largësi të madhe dhe përdorimet e teknologjisë:*

Programe radio-televizive të ndjekura; herojtë dhe personazhet e filmave të ndjekur nga ky grup-moshë;

Korrespondenca elektronike me miqtë; kompiuteri, SMS etj.;

*dh. Bota e imagjinatës dhe krijimtarisë veprimtaritë artistike dhe krijuese:*

Lojërat, sporti, garat; llojet e lojërave, lojërat kompiuterike, veshjet e pajisjet sportive;

Kultura popullore, muzika, veprimtaritë në kohën e lirë.

e. Tregime, përshkrime vendesh e ngjarjesh.

## **5.2. Leksiku**

Përzgjedhja e teksteve bazohet mbi një repertor leksikor, pjesa më e madhe e të cilave i përkasin fjalorit bazë të gjuhës italiane, ndërsa pjesa tjetër lidhet me fusha dhe kontekste përdorimi të veçanta për grup-moshën.

## **VI. ELEMENTE DHE STRUKTURA GRAMATIKORE**

### **6.1. Morfosintaksa**

Strukturat e parashikuara synojnë të nxisin aftësinë komunikuese të nxënësve duke aktivizuar funksionet minimale. Këto janë strukturat më të përdorshme që bëjnë të mundur realizimin e komunikimit në një nivel minimal brenda fushës tematike të përzgjedhur;

Niveli i nxënësve paramendon zotërimin e këtyre strukturave morfo-sintaksore:

-mbiemri cilësor dhe përcaktor;

-rimerret zgjedhimi i foljeve të rregullta në mënyrat dhe kohët e mëposhtme, format vetvetore a përemrore:

-indicativo (presente, passato prossimo, imperfetto, futuro anteriore, trapassato prossimo)

-urdhërore, urdhërore me trajtat përemrore

-përcjellore (stare + përcjellore).

-forma e mirësjelljes me kushtore.

-mbiemri dhe përemri i pacaktuar;

-lidhëzat;

-parafjalët e thjeshta dhe të përbëra;

-fjalitë e thjeshtë në katër llojet themelore (dëftore, pyetëse, habitore, urdhërore);

-fjalitë me bashkërenditje e nënrenditje;

-zgjedhime të parregullta foljesh në tri kohët bazë (e tashme, e kryer, e ardhme);

-foljet kalimtare dhe jokalimtare;

-forma pasive, aktive e foljeve;

-foljet modale + paskajore.

### **6.2. Fonetika**

Fonetika ka për qëllim t'i aftëspjë nxënësit për një shqiptim korrekt të fjalëve dhe fjalive me intonacionin dhe muzikalitetin e duhur.

## **VII. SHPËRNDARJA E ORËVE**

35 javë x 3 orë = 105 orë

Aspekti komunikues-kulturor: 50 orë

Aspekti gjuhësor: 40 orë

Të lira: 15 orë

*Aspekti komunikues-kulturor (50 orë).* Pa rënë ndesh me parimin e autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, përgjithësisht këshillohet që afër 32 orë mësimore t'u kushtohen veprimtarive me karakter komunikues, përfshirë këtu të ushtruarit, në situata komunikuese, të njohurive, strukturave, nocioneve që ngërthejnë materialet e ndryshme didaktike, si: teksti, materiale integruese etj., rimarrjen dhe përsëritjen e njohurive të fituara deri në atë pikë, rimarrjen dhe përforsimin deri në ngulitje të funksioneve, nocioneve e strukturave komunikuese më të rëndësishme.

*Aspekti gjuhësor (40 orë).* Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi ftohet të shtjellojë, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore, ushtrime gjuhësore (gramatikore e leksikore), rimarrje dhe përforsim të atyre të mësuara më parë apo edhe të atyre të reja.

*Të lira (15 orë).* Në këto orë të lëna në dispozicion të mësuesit, mund të zhvillohen orë përsëritjeje, detyra kontrolli, plotësim të orëve kushtuar aspektit qoftë komunikativ, qoftë gjuhësor.

### **VIII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT**

Në kurrikulat e reja të gjuhëve të huaja mësuesi është i lirë të zgjedhë metodën që gjykon si më të përshtatshme në kushtet e klasës në të cilën punon, mjaft që të përmbushë programin dhe objektivat e parashikuar.

Nxënësve t'u krijohet mundësia për të marrë pjesë në veprimtari në të cilat ndërthuren dy apo më shumë aftësi gjuhësore, për të përdorur gjuhën për qëllime reale, për të vënë në zbatim aftësitë e tyre.

Një mundësi me karakter metodologjik lidhet me parimin sipas të cilit nuk mund të realizohet të nxënit pa pjesëmarrjen aktive të nxënësit. Për të nxitur këtë pjesëmarrje, të përdoren veprimtari në të cilat të ndërfitet sa më shumë të jetë e mundur nxënësi.

Për të ngjallur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve duhen përdorur sa më gjerësisht teknikat e dramatizimit, role-play etj., të cilat bëjnë të mundshme një përfshirje fizike dhe emotive të nxënësit në veprimtari në grup e në çifte dhe i krijojnë mundësi atij të dalë jashtë mjedisit shkollor, duke shkarkuar tensione, frustrime e duke shmangur filtrin afektiv bllokues, si edhe të nxjerrë në pah personalitetin e vet. Dramatizimi e role-play i krijojnë mundësi pjesëmarrjeje përmes dialogjeve në shkëmbime me karakter komunikues, të cilat lypin kryerjen e një roli të caktuar në një mjedis të përcaktuar. Ato bëjnë të mundur përdorimin e disa kanaleve shprehëse për komunikimin: gjuhën, veprimin, gjestin.

Në metodat e reja komunikuese nxënësi gjen vetveten dhe është më i lirshëm për t'u shprehur. Këshillohet puna në grup, mbasi informacioni përgatitet nga të gjithë dhe përgjegjësia për suksesin apo mospësuksin u takon të gjithëve. Kjo i ndihmon që të ndjehen të bashkuar dhe njësoj të vlerësuar.

Për t'i nxitur nxënësit të shprehen, të komunikojnë duke zhvilluar dhe duke ushtruar aftësitë e tyre potenciale, është e nevojshme kryerja e veprimtarive shprehëse, krijuese, reflektuese, analizuese. Për këtë nevojitet:

Së pari, t'u jepet nxënësve një input më i zgjeruar, nocione dhe njohuri të reja, më të zgjeruara, më të plota e më të thella se ato të ciklit fillor.

Së dyti, të nxiten nxënësit të mbajnë qëndrim për materialin didaktiko-edukativ që u jepet.

Së treti, të nxiten ata të diskutojnë, të debatojnë (përmes përdorimit të gjuhës italiane). Si garanci për të arritur suksesin në punën tonë si mësues do të shërbejë pjesëmarrja e nxënësve në veprimtari komunikuese, në shkëmbime, të cilat çojnë më pas në rritjen e motivimit dhe në nxitjen e të shprehurit, prej nga kalohet drejt një procesi analize, pjekurie dhe mendimi kritik nga ana e tyre.

Për shpjegimet e ndryshme, si edhe për paraqitjen e veprimtarive praktike, mësuesi të përdorë një gjuhë të qartë e të kuptueshme, një ritëm normal, një shqiptim të dallueshëm e të qartë.

Roli i mësuesit ndryshon. Ai tani luan një rol mbështetës dhe nxitës të veprimtarive individuale dhe autonome të nxënësve. Mësuesi nxit dhe krijon situata mësimore reale.

Gjatë veprimtarive në klasë, mësuesi të përpiqet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundshme gjuhën italishte. Sidoqoftë, për të shmangur raste moskuptimi që nuk do të lejonin zhvillimin e një veprimtarie të caktuar në mënyrën e duhur, të përdoret edhe gjuha amtare.

Pas paraqitjes së veprimtarisë apo të lojës, të fjalëve apo strukturave të reja, mësuesi, të mënjanohet fillimisht nga roli i aktorit e të kalojë në atë të regjizorit që drejton aktorët (nxënësit), duke i nxitur ata e duke dhënë *input*-e apo skena të reja.

Gjuha e përdorur në klasë të jetë e saktë brenda standardit bashkëkohor, në formën, ritmin dhe intonacionin e vet autentik.

Llojshmëria e teknikave didaktike do të bëjë të mundshme që të gjithë nxënësit të përfitojnë duke patur parasysh faktin se aftësitë e tyre nuk janë të njëjta apo të barabarta. Lipset që në punën me grupe apo skuadra mësuesi të përpiqet të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve duke i nxitur të shprehen lirisht.

Reflektimi gjuhësor të jetë:

-Induktiv dhe konkret. Është nxënësi ai që, duke ndjekur mënyrën induktive, zbulon rregullën përmes veprimtarish konkrete gjuhësore.

-I paraqitur në formë veprimtarie apo problemi për zgjidhje, i tillë që ta nxisë nxënësin të vërë në përdorim aftësitë e veta vëzhguese;

-I bazuar jo mbi një metodologji të përqendruar në shpjegimin e rregullës nga mësuesi, por që synon në zbulimin e saj nga vetë nxënësit, natyrisht i ndihmuar edhe nga mësuesi.

Vëzhgimet sistematike të kryera nga ana e mësuesve gjatë procesit mësimor përbëjnë një mjet të favorshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimit, duke u dhënë mundësinë mësuesve që të përfshijnë në kohën dhe vendin e duhur ato përmirësime apo plotësime që ata i gjejnë të nevojshme. Kur niveli i nxënësve të klasës VIII, për arsye e shkaqe të ndryshme, del më i lartë se ai i përcaktuar në këtë program, atëherë, për të mos shkaktuar demotivim, si edhe për të shmangur monotoninë, mësuesi mund të propozojë e t'u paraqesë nxënësve të tij materiale të tjera gjuhësore, të zgjedhura e të përgatitura nga vetë ai, duke i integruar me materialin e tekstit të gatshëm, duke ndjekur udhëzimet e mëposhtme:

-të garantojë natyrshmërinë e gjuhës së paraqitur;

- të garantojë përshtatshmërinë e gjuhës me situatën e dialogjeve;
- të kufizojë strukturat dhe leksikun e ri të paraqitur;
- të ketë parasysh që gjatësia e tekstit të ofruar të jetë e mjaftueshme për kontekstualizimin e formave të reja që të bëhet kështu i mundur një kuptim dhe një dramatizim i thjeshtë i tekstit;
- të paraqesë një farë shkalle interesi për nxënësit;
- të përdorë mjete vizive ndihmëse (objekte, pamje, fotografi, revista etj., kur i mungojnë aparataturat tv), të cilat e bëjnë të qartë kontekstin e dialogut dhe e lehtësojnë kuptimin global të materialit të paraqitur;

## **IX. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI**

Vlerësimi i përparimit të nxënësit realizon matjen e përparimit dhe të arritjeve në gjuhën italiane. Megjithë karakterin shpesh subjektiv, kontrolli gojor në fillim të çdo ore mësimi është një element i rëndësishëm për të vlerësuar çka është mësuar më parë. Një pedagogjie të diferencuar i korrespondon një vlerësim i diferencuar, që i mundëson secilit nxënës të konstatojë progresin e vet, cilido qoftë niveli i arritur.

Njohja dhe vlerësimi i arritjeve dhe mangësive të nxënësve bëhet duke i dëgjuar ata kur flasin dhe lexojnë ose duke vëzhguar të shkruarit e tyre. Të aftësosh nxënësin që ata t'i përgatitin vetë pyetjet për t'ua drejtuar nxënësve të tjerë, është një ushtrim shumë i mirë për zhvillimin e aftësisë komunikuese.

Vlerësimi formues vë në dukje arritjet e nxënësit në përvetësimin e programit, si dhe ndihmën që jep mësuesi për shmangien e gabimeve.

Vlerësimi përmbledhës bëhet në fund të një numri të caktuar temash, kapitujsh, në fund të semestrit apo të vitit. Ai bëhet në përputhje me objektivat mësimorë. Është e rëndësishme që nxënësi të nxitet drejt vetëvlerësimit, që ai të ndërjegjësohet për arritjet e punës së vet.

Për të siguruar një vlerësim efektiv të procesit mësimor, të pikënisjes dhe të pikëmbërritjes, të vështirësive të hasura, si edhe të masave të ndërmarra, mësuesit të mbledhin në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme informacion lidhur me zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe të aftësive, lidhur me gatishmërinë ndaj të nxënit, me shkallën e ndërjegjësimit për çdo nxënës.

Informacionet të mblidhen në mënyrë sintetike që të bëjnë të mundur një ballafaqim të nivelit të përparimit individual dhe kolektiv, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së marrë në shqyrtim. P.sh., aftësitë me shkrim të vlerësohen përmes veprimtarive të tilla, si: shkrimi i fjalëve të veçuara apo frazave të shkurtëra, plotësimi i vendeve bosh brenda fjalëve apo frazave të shkurtëra, përmes batutave të shpeshhta në një dialog të shkurtër, mesazheve të urimit, listave të thjeshta me emra rrobash, ushqimesh, sendesh të klasës apo të shtëpisë etj.

### **KRITERET E HARTIMIT TË TEKSTIT TË KLASËS SË TETË**

Për hartimin e tekstit të nxënësit duhet patur parasysh grup-mosha së cilës i drejtohet, si dhe në sa orë javore dhe vjetore do të zhvillohet kjo metodë.

Fakti i të mësuarit është një process i natyreshëm që qëndron në ndjekjen e objektivave të mirëpërcaktuar. Për këtë kërkohen:

-Objektiva të qartë gjuhësoro-komunikues, si:

1. Të mësosh të komunikosh në gjuhën italiane me gojë dhe me shkrim;
2. Të mësosh funksionimin progresiv të gjuhës;

### 3. Të njohësh Italinë.

Në këtë funksion, të propozohen teknika dhe strategji që lehtësojnë mësimdhënien dhe e çojnë nxënësin në një mësim autonom.

-Teksti të jetë i ndarë në njësi didaktike.

-Tematika e zgjedhur ku të përfshihen veprimtari të jetës së përditshme sa më afër interesave të nxënësve, që të mund të flasin për veten e tyre, për personat që i rrethojnë etj.

-Të jetë me materiale autentike, me ilustrime me ngjyra.

-Të ketë strategji ndërvepruese për të zhvilluar tek nxënësit: "Unë di të bëj" (saper fare), "Unë di të jem" (saper essere).

-Gramatika të jetë e ndërthurur me objektivat komunikues.

-T'u përshtatet zhvillimit emocional të nxënësve.

-Të ketë format të madh, për t'u lexuar qartë nga ana e nxënësve.

-Të ketë ushtrime për zhvillimin e imagjinatës, lidhjen ndërlëndore, histori, gjeografi etj.

-Të ketë një baraspeshë ndërmjet veprimtarive individuale dhe kolektive.

-Të mbështetet në katër aftësitë.

Rubrika për qyteterimin i ndërgjegjëson nxënësit për pasurinë dhe diversitetin e kulturës botërore dhe nxit tek ata dëshirën për të hyrë në komunikim me të rinjtë e moshës së tyre.

Veprimtaritë të bëhen të gërshetuara me mësimet nëpërmjet teksteve të shumta dhe fotografive.

Metoda të shoqërohet me një libër të veçantë ushtrimesh, ku nxënësi të mund të punojë në mënyrë të pavarur.

Metoda të shoqërohet me kasetë dhe me libër për mësuesin.